



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

---

**Datë:** 20.06.2025  
**Numër Protokolli:** 4723/2025

**A.nr.709/2024**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.709/2025, të datës 23.04.2025, të parashtruar nga ankuesi A.K, kundër organit të punësimit: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 17.06.2025, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.709/2025, e datës 23.04.2025, e parashtruar nga ankuesi, A.K. **Anulohet** në tërësi procedura e pranimit me numër reference RN00016977, për Grupin Arkiv-Dokumentacionit, pozita Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve, në Zyrën Lokale të Pensioneve në Mitrovicë, i shpallur me datë 07.03.2025, nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

**II. Obligohet** Udhëheqësi/ja i/e Njesisë së Personelit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, që brenda aftit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet administrative për zbatimin e këtij vendimi siç përcaktohen në pikën I të dispozitivit.

**III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Kandidati për pranim në shërbim civil, A.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 23.04.2025, përmes adresës elektronike [ankesa.kpmsk@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmsk@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 18.04.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore, në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, për refuzimin e aplikacionit në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016977.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 07.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa, kjo e fundit, më datë 23.05.2025, ka përcjellë provat referuar çështjes në procedurë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova:* Ankesën me numër protokollit 2693/2025 të datës 23.04.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin, të datës 18.04.2025; Formularin e parashtrimit të ankesës; kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.05.2025; Konkursin me numër reference RN00016977; Formularin e vlerësimit të esesë së kandidatëve të datës 29.04.2025; Njoftimin për testin me shkrim; Njoftimin për intervistën me gojë; Formularin e vlerësimit të intervistës me gojë të datës 02.05.2025; Vendimin Nr.133/2025 të datës 16.04.2025; Listën e aplikantëve; Njoftimin e datës 18.04.2025; Njoftimin përfundimtar të vlerësimit të datës 02.05.2025; renditjen përfundimtare nga SIMBNJ; Esenë së bashku me çelësin e eses; Çelësin e pyetjeve të intervistës me gojë nga komisioni i pranimit; Akt emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit; Aplikacioni me datë aplikimi 10.03.2025 i kandidatit R.P së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 18.03.2025 i kandidatit A.K së bashku me dokumentet e bashkangjitura.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave materiale të lëndës rezulton se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 07.03.2025, ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00016977, për Grupin të Arkiv-Dokumentacionit, respektivisht për pozitën *Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve*, në Zyrën Lokale të Pensioneve në Mitrovicë, me klasë të pozitës Profesional 2, për 1 (një) vend pune, i hapur për aplikim nga data 08.03.2025 deri më datë 06.04.2025. Tutje, sipas provave materiale të lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, të cilit sipas njoftimit të datës 18.04.2025, të Njesisë së Personelit i është refuzuar aplikacioni mbi arsytimin së nuk ka plotësuar kriterin e arsimimit.

Njësia e Personelit, në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, më datë 02.05.2025, ka publikuar Njoftimin për kandidatin fitues, nga i cili akt rezulton se kandidati me më së shumti pikë për pozitën përkatëse është shpallur Raif Peci, me gjithsejtë 92.4 pikë.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar Vendimin për refuzimin e aplikacionit për procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016977, me pretendimin ankimor se i njëjti me rastin aplikimit në procedurën përkatëse ka bashkangjitur dy diplomat, për përfundimin e studimeve themelore dhe master, në drejtimin e Menaxhimit të Administratës Publike, drejtim ky i lidhur ngushtë me arkiv-dokumentacionin. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të rishqyrtoj aplikacionin në mënyrë të drejtë.

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e rekrutimit RN00016977. Rrjedhimisht, në kontekst të këtij përcaktimi, e në kuptim të kritereve formale të

përgjithshme Kolegji ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit me numër reference RN0001697, dhe si pasojë ka konstatuar së pozita *Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve*, është shpallur në Grupin e veçantë Arkiv-Dokumentacionit, klasa Profesional 2, ndërsa, si kritere të përgjithshme formale janë vendosur: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor); Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.** Si rrjedhojë, Kolegji konstaton së organi i punësimit në këtë rast njësia përgjegjëse e MFPT-ja me rastin e shpalljes së konkursit përkatës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogun e vendeve të punës në shërbim civil, mbi arsytet se, sipas Shtojca Nr. 2: [Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm], të Rregullores Nr.06/2024 dhe Katalogut të vendeve të punës në shërbim civil, si fusha të kërkuar të arsimit për grupin e Arkives janë përcaktuar: **Arkivë, Histori, Histori e Artit, Antropologji, Orientalistikë, Ballkanistikë dhe nën-specializime të konservimit**, ndërsa, MFPT më rastin e shpalljes së konkursit të kontestuar, ka vendosur fushë të hapur të arsimit, gjegjësisht nuk ka përcaktuar fushë të arsimit ashtu siç parashihet për këtë grup të veçantë, andaj, mbi bazën e këtyre konstatimeve, e në kuptim të nenit 19 dhe nenit 31 paragrafi 1 dhe 2, të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: “19. **Kërkesat e përgjithshme formale, përfshijnë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës që janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi;** 30.1. **Me qëllim të lehtësimit të procesit të klasifikimit dhe grupimit të vendeve të punës për kategorinë profesionale, hartohet katalogu i vendeve të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrisë Përgjegjëse për Administratë Publike.** 30.2. **Katalogu i vendeve të punës përmban emërtimin e pozitës, kategorinë, klasën, grupin dhe kriteret e përgjithshme si dhe përshkrimin e vendit të punës për çdo pozitë.**”, konstatoi se MFPT me rastin e shpalljes së konkursit për pozitën *Zyrtar për administrimin e dokumenteve*, ka vepruar në kundërshtim me ligjin material duke ndryshuar kriteret formale lidhur me fushën e arsimit

Ndërsa, përkundër që më konkursin RN00016977 nuk ishte përcaktuar fusha e arsimit, Njësia e Personelit të organit përkatës të punësimit, kishte refuzuar aplikacionin ankuesit me përfundimin se nuk ka diplomë të fushës që i përket grupit të arkivit, veprime këto që bien ndesh me vet përcaktimet e konkursit.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si më sipër, Kolegji vlerëson së vendosja e kritereve të konkursit në kundërshtim me kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, ka bërë që procedurat e kontestuar të kualifikohen si veprime të paligjshme administrative në kuptim të nenit 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Rrjedhimisht, duke qenë së akti e shpalljes së konkursit kontestuese është përfshirë më shkelje esenciale materiale, atëherë, çdo veprim tjetër procedural i ndërmarrë në këtë procedura është juridikisht i pavlefshëm dhe nuk prodhon efekte juridike, kështu që, mbi këtë bazë të konstatimit, Kolegji nuk ka trajtuar ligjshmërinë e fazave tjera procedurale, të pasuara pas përmbylljes së konkurseve përkatëse.

Thënë si më lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, duke anuluar në tërësi procedurat e pranimit të shpallura sipas konkursit me numër reference RN00015030 dhe RN00015034.

**Këshillë juridike:** Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda

